

Vendim nr. 153, datë 07.05.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sandër Beci, Anëtarë, në datën 07.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (E) 2026 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **EDUARD STRUGAJ**, përfaqësuar nga avokatët Luan Kaloçi dhe Altin Gjata, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 78, datë 02.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 26, datë 21.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1283, datë 29.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, pika 2, 18, 30, 31, 32, pika 2, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; nenet 27, 39, 45, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është emëruar në detyrën e drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) “Jordan Misja”, Tiranë, sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 463, datë 11.10.2019. IEVP-ja disponon një ambient të quajtur “Njësi Tregtare”, me anë të së cilës sigurohen nevojat që kanë të paraburgosurit për mallra të ndryshme, që jepej me qira konform vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “*Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, të ndryshuar. Mbi këtë bazë ligjore, ndërmjet IEVP-së dhe një subjekti, personit fizik S.D., është lidhur kontrata e qirasë me nr. 130 prot., datë 23.01.2019, me objekt “*Marrjen me qira të njësisë tregtare të këtij institucioni me sipërfaqe 8 m² dhe çmim qiraje 360 lekë për m²*”. Kontrata është lidhur me afat të pacaktuar, por parashikohej mundësia e ndërprerjes në çdo kohë pa penalitete të ndërsjella nga palët.

2. Me shkresën e datës 25.11.2019, shtetasi S.D. ka njoftuar IEVP-në se kërkonte lejimin e futjes së disa makinerive për bërjen e kafes për t’u shërbyer të paraburgosurve, nëpërmjet shtetasit I.P., i cili kishte filluar aktivitetin e tregtimit të kafesë brenda ambienteve të IEVP-së, duke futur 8 makineri kafeje. Ky shtetas ka pretenduar se nga ana e kërkuesit dhe përgjegjësit të logjistikës i është kërkuar përfitim i parregullt, me qëllim që të lejohej të ushtronte aktivitetin brenda ambienteve të IEVP-së. Nga ana e IEVP-së, në datën 12.02.2020, është bërë ndërprerja e kontratës me shtetasin S.D. për mospërbushje të kushteve të kontratës dhe mbarim të afatit, ndërkohë që pas zhvillimit të një procedure përzgjedhjeje, është lidhur kontrata me subjektin E.K., i cili kishte mangësi në dokumentacion dhe e kishte dorëzuar ofertën pas afatit.

3. Në këto kushte, shtetasi I.P. ka paraqitur kallëzim penal dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) ka regjistruar procedimin penal nr. 89 të vitit 2020 (procedimi penal nr. 89/2020) për veprat penale “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 259 dhe 25 të Kodit Penal (KP), për kërkuesin dhe shtetasin F.A., si dhe “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, të parashikuar nga neni 244 i KP-së, ndaj shtetasit E.K., si dhe ka vendosur në përgjim kërkuesin dhe dy të bashkëpandehurit. Në vijim, me urdhër të prokurorit, në datën 09.11.2020 në regjistrin e procedimit penal janë shtuar edhe veprat penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike*” dhe “*Shpërdorimi i detyrës*”, të parashikuara nga nenet 258 dhe 248 të KP-së, duke urdhëruar ndarjen e akteve të procedimit penal nr. 89/2020 dhe numërtimin e tyre 89/1 datë

16.11.2020. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Posaçme e ka dërguar çështjen në gjyq, duke e akuzuar kërkuesin për veprën penale të parashikuar nga nenet 259 dhe 25 të KP-së.

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me gjykim të shkurtuar, me vendimin nr. 78, datë 02.12.2021, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit dhe dy të bashkëpandehurve të tjerë për veprat penale për të cilat akuzoheshin, duke e dënuar përfundimisht pas aplikimit të nenit 406 të KPP-së kërkuesin me 1 vit e 8 muaj burg dhe 5 vjet heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike. Kundër këtij vendimi kërkuesi dhe të bashkëpandehurit kanë paraqitur ankim.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 26, datë 21.04.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 78, datë 02.12.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit dhe 2 të bashkëpandehurve, me vendimin nr. 00-2025-1283, datë 22.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 02.02.2026 (sipas shërbimit postar) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 23.04.2026 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për një proces të rregullt gjyqësor në drejtin të:*

7.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtarja D.Sh., që ka qenë relatore e trupit gjykues në shkallë të parë, e cila ka nënshkruar edhe vendimin për pranimin e gjykimit të shkurtuar, para përfundimit të procesit është transferuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit, ku, në vijim, ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka marrë në shqyrtim çështjen e tij.

7.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi argumentet e gjykatave të zakonshme lidhur me rezultatet e veprimeve simuluese se ai ka favorizuar një subjekt tjetër, janë alogjike dhe abuzive. Gjithashtu, janë shtrembëruar dhe tjetërsuar faktet e provuara lidhur me lejimin e veprimeve simuluese.

7.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat i kanë paragjykuar veprimet administrative konkrete të kryera nga kërkuesi për lidhjen e kontratës me të tjerë, duke përjashtuar personin që kishte kryer abuzime me futjen e sendeve të kundërligjshme në IEVP, ndërkohë që ai nuk kishte njohje me personat e përfshirë, për shkak edhe të kohës së shkurtër në drejtimin e institucionit. Gjithashtu, nga asnjë provë ose rrethanë nuk rezulton që ai të ketë kërkuar ose marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi ndonjë përfitim të parregullt ose ndonjë premtim për vete ose persona të tjerë. Këto pretendime janë konsideruar të drejta edhe nga një gjyqtar i GJKKO-së së Shkallës së Parë në mendimin e pakicës.

7.3. *Parimi i sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur të njëjtin standard qëndrimi juridik, sipas praktikës së mëparshme të saj në lidhje me veprimet simuluese të kryera nga persona që nuk përmbushin kërkesat e ligjit, si në rastin e vendimit nr. 00-2013-1211 (85) datë 06.03.2013, duke krijuar pabarazi.

7.4. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi veprimet simuluese janë kryer në kundërshtim me ligjin. Si prokuroria, ashtu edhe gjykatat nuk kanë marrë në analizë elementet e provueshmërisë së paligjshmërisë së këtyre veprimeve, të cilat nuk kanë qenë të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit dhe as nuk është realizuar provueshmëria e pasjes dijeni të tij. Vetë veprimet janë kryer me provokim, pa të drejtë nga një person që cenohej nga realizimi i kontratës, çka bie ndesh me KPP-në.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës,

pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

11. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi veprimet simuluese janë kryer në kundërshtim me ligjin. Si prokuroria, ashtu edhe gjykatat nuk kanë marrë në analizë elementet e provueshmërisë së paligjshmërisë së këtyre veprimeve, të cilat nuk kanë qenë të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit dhe as nuk është realizuar provueshmëria e pasjes dijeni të tij. Vetë veprimet janë kryer me provokim, pa të drejtë nga një person që cenohej nga realizimi i kontratës, çka bie ndesh me KPP-në.

13. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi argumentet e gjykatave të zakonshme, lidhur me rezultatet e veprimeve simuluese se ai ka favorizuar një subjekt tjetër, janë alogjike dhe abuzive. Gjithashtu, janë shtrembëruar dhe tjetërsuar faktet e provuara lidhur me lejimin e veprimeve simuluese.

14. Për sa u takon këtyre pretendimeve të kërkuesit, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ato nuk janë ngritur nga kërkuesi as në ankim, as në rekurs, duke mos shteruar në këtë

mënyrë të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese. Në këtë kontekst, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera të tij, konkretisht pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, ai është ngritur në substancë në të tria shkallët e gjyqësorit, ndërkohë që pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është ngritur nga kërkuesi në rekurs, ndaj Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ai i ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke mos pasur mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se edhe për pretendimin e kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit, që ka të bëjë me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Prandaj, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se edhe në këtë rast kërkuesi e ka përmbushur këtë kriter.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 29.07.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 02.02.2026. Për këtë arsye, nga ana e kërkuesit bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur shkresa nr.190/1 prot., datë 16.01.2026 dërguar nga Gjykata e Lartë, mbi kërkesën e tij, që thekson se vendimi i saj është bërë i disponueshëm për palët në datën 15.10.2025. Në këto kushte, rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor e për pasojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

18. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të paanshmërisë. Kërkuesi, po ashtu, ka pretenduar edhe cenimin e sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit, si dhe cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

19. Për pretendimin e cenimit të *sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit*, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur të njëjtin standard qëndrimi juridik, sipas praktikës së mëparshme të saj në lidhje me veprimet simuluese të kryera nga persona që nuk përmbushin kërkesat e ligjit, si në rastin e vendimit nr. 00-2013-1211 (85) datë 06.03.2013, duke krijuar pabarazi.

20. Gjykata ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke mbajtur parasysh standardin e mësipërm, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se argumentet e dhëna nga ana e kërkuetit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit nuk qëndrojnë, pasi vendimi i cituar, i ngjashëm në dukje, nuk është vendim unifikues ose njësues i detyrueshëm për zbatim, ndaj ai është i pamjaftueshëm për të krijuar pritshmëri të ligjshme nga ana e kërkuetit. Në këtë kontekst, ky pretendim i kërkuetit është haptazi i pabazuar.

22. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat i kanë paragjykuar veprimet administrative konkrete të kryera nga kërkuesi për lidhjen e kontratës me të tjerë, duke përjashtuar personin që kishte kryer abuzime me futjen e sendeve të kundërligjshme në IEVP, ndërkohë që ai nuk kishte njohje me personat e përfshirë, për shkak të kohës së shkurtër në drejtimin e institucionit. Gjithashtu, nga asnjë provë ose rrethanë nuk rezulton që ai të ketë kërkuar ose marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi ndonjë përfitim të parregullt ose ndonjë premtim për vete ose persona të tjerë. Këto pretendime janë konsideruar të drejta edhe nga një gjyqtar i GJKKO-së së Shkallës së Parë në mendimin e pakicës.

23. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërkohë në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë

procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuesit, Mbledhja e Gjyqtarëve do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit gjykatat e posaçme dhe Kolegji Penal kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, që kanë të bëjnë me vlerësimin e dyshimeve në favor të kërkuesit, si dhe prezumimet ligjore dhe të faktit në përcaktimin e fajësisë së tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

25. Duke iu rikthyer rastit konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka çmuar se fajësia e kërkuesit provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm nga indicie të cilat përputhen me njëra-tjetrën dhe provohet se ai ka pranuar mitë me qëllim lejimin e ushtrimit të aktivitetit tregtar në ambientet e IEVP-së. Indiciet lidhur me marrjen e mitës jo vetëm nga i bashkëpandehuri F.A., por edhe nga kërkuesi, vërtetohen nga provat e administruara gjatë gjykimit dhe konkretisht nga veprimet simuluese ka rezultuar se i bashkëpandehuri F.A. ka marrë mitën në vlerën 100.000 lekë nga kallëzuesi I.P. që është autorizuar për kryerjen e veprimit simulues, shumë kjo që i është gjetur atij gjatë kontrollit personal në momentin e daljes nga IEVP-ja. Për sa i takon kërkuesit, indicie lidhur me marrjen e mitës jo vetëm nga shtetasi F.A., por edhe nga ai, në cilësinë e eprorit të këtij të fundit, kanë rezultuar nga provat e administruara gjatë gjykimit dhe konkretisht nga përgjimet telefonike, të dhënat e ekstraktuara nga telefonat celularë të sekuestruar, deklaratimet e shtetasve I.P., S.D. dhe E.A., si dhe nga procedura për zgjidhjen e kontratës së qirasë. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vlerësuar se fajësia e kërkuesit provohej edhe nga komunikimet e të bashkëpandehurit tjetër E.K. me shtetas të tjerë, ku duket se ky shtetas ka dhënë mitë edhe për drejtorin.

26. GJKKO-ja e Apelit, nga ana e saj, ka çmuar se e gjen të drejtë si analizën që u është bërë provave nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ashtu dhe konkluzionet mbi faktet që rezultojnë të provuara pas çmuarjes në tërësi të tyre, në përputhje me nenin 152 të KPP-së. Sipas saj, nga provat e analizuara rezulton se kërkuesi dhe i bashkëpandehuri F.A. kanë vepruar në marrëveshje, në kuptim të nenit 25 të KP-së, për realizimin e faktit kriminal në të gjitha elementet e tij materiale, duke kërkuar dhe pranuar përfitim të parregullt, me qëllim lejimin e

ushtrimit të aktivitetit tregtar në ambientet e institucionit, IEVP-së, nga shtetasi I.P. Fajësia e kërkuarit, sipas asaj gjykate, është provuar nga përgjimet telefonike, të dhënat e ekstraktuara nga telefonat celularë të sekuestruar, deklaratimet e personave që tregojnë rrethana të hetimit, si dhe procedura e zgjidhjes së kontratës me shtetasin S.D., me kërkesë të të cilit ishte lejuar shtetasi I.P. të ushtronte aktivitetin tregtar të tregtimit të kafesë nëpërmjet makinerive të vendosura në IEVP. Gjykata e Apelit, në përcaktimin e fajësisë së kërkuarit, ndër të tjera, ka vlerësuar deklaratimet e shtetasit I.P., në cilësinë e kallëzuesit, ku pranohet fakti i dhënies së përfitimit të parregullt në total për rreth 457.000 lekë për F.A. dhe kërkuarin në cilësinë e drejtorit të IEVP-së. Dhënia e ryshfetit është konfirmuar edhe nga i bashkëpandehuri tjetër E.K., si subjekt tregtar, si dhe nga procedura e zgjidhjes së kontratës me subjektin paraardhës si pasojë e mospranimit të presionit dhe vlerës në rritje të kërkuar nga kërkuari dhe F.A.

27. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij për mospranimin e rekursit të kërkuarit, ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrim të njëjtë lidhur me cilësimin ligjor të fakteve penale në ngarkim të kërkuarit, duke arsyetuar në lidhje me përgjegjësinë penale të tij, në raport me faktin, provat dhe ligjin. Ai kolegji arsyeton se vendimmarrja objekt rekursi është e argumentuar si në drejtim të fajësisë së kërkuarit, ashtu dhe për sa i përket masës dhe llojit të dënimeve të caktuara ndaj tij. Kolegji Penal vlerëson se GJKKO-të, në përputhje me nenin 152 të KPP-së, i kanë çmuar provat në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar dhe duke mos mbivlerësuar asnjë prej provave të marra e të verifikuara në këtë gjykim.

28. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, mbahet parasysh fakti se Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtyre standardeve dhe në kushtet kur mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme është vënë në dyshim nga kërkuari, si shkak për të cilin atij i është cenuar e drejta themelore për t'u prezumuar i pafajshëm, në vijim do të analizohet vlerësimi i provave në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuarit në kuptimin e garancive të parimit të prezumimit të pafajësisë, pra nëse fajësia e këtij të fundit është vendosur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në respektim të parimit *in dubio pro reo*.

29. Në këndvështrim të sa më sipër, si dhe bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të paraqitura nga kërkuesi, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ai nuk ka arritur të argumentojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e të drejtave të tij kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vlerësuar gjykatat në rastin konkret përcaktimin e fajësisë së tij. Konkretisht, nga vendimet objekt shqyrtimi rezulton se nga të dyja gjykatat e posaçme janë administruar një sërë provash, si përgjime komunikimesh, veprim simulues, dëshmi të personave që kanë dijeni, si dhe ekstraktim i të dhënave nga telefonat celularë të sekuestruar. Fajësia e kërkuesit është provuar nëpërmjet komunikimeve të tij me të bashkëpandehurin F.A., nga të dhënat e ekstraktuara nga telefonat e sekuestruar, nga deklaratimet e shtetasve I.P. dhe E.K., nga praktika e ndërprerjes së kontratës së shërbimit me subjektin paraardhës, si dhe nga prova dhe indicie të tjera. Nga vlerësimi i këtyre provave dhe indicieve të tjera, në përputhje me njëra-tjetrën, nuk rezulton që t'i jetë dhënë vlerë e paracaktuar ose të jetë mbivlerësuar ndonjë prej provave, ndërsa është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe gjykatat e posaçme kanë kryer një analizë të detajuar të mekanizimit që e vërteton këtë akuzë. Në këtë kuadër, nga analiza e vendimeve të gjykatave të zakonshme, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se nuk rezulton se çmuarja e provave ose zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë gabime faktike ose ligjore të dukshme, që t'i bëjë vendimet gjyqësore arbitrare. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është haptazi i pabazuar.

30. Për sa i takon pretendimit tjetër të kërkuesit, cenimit të *parimit të paanshmërisë*, ai ka pretenduar se gjyqtarja D.Sh., që ka qenë relatores e trupit gjykues në shkallë të parë, e cila ka nënshkruar edhe vendimin për pranimin e gjykimit të shkurtuar, para përfundimit të procesit është transferuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit, ku në vijim ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka marrë në shqyrtim çështjen e tij.

31. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka çmuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 70, datë 17.11.2015; nr. 1, datë 25.01.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret, mbi kërkesën e të bashkëpandehurit F.A., gjyqtari i vetëm i GJKKO-së së Apelit, me vendimin/urdhrin nr. 5, datë 06.04.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit dhe caktimin e gjobës 5000 lekë, pasi kërkesa është konsideruar haptazi e pabazuar. Në vijim, rezulton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi këtë pretendim, të ngritur tashmë në rekurs edhe nga kërkuesi, ka arsyetuar se anëtarja e trupit gjykues, gjyqtarja D.Sh., për shkak të transferimit të saj, nuk është shprehur me vendim përfundimtar për çështjen në gjykim dhe nuk rezulton që ajo të ketë dhënë mendim mbi këtë procedim. Sipas atij kolegji, vendimmarrja që ka të bëjë me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, nuk përbën shkak për papajtueshmërinë funksionale të gjyqtarit, pasi rastet e papajtueshmërisë së gjyqtarit janë të përcaktuara taksativisht në nenet 15 dhe 17 të KPP-së, aq më tepër në kushtet kur është pranuar kërkesa procedurale e të pandehurve për vijimin me gjykim të shkurtuar.

34. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se gjyqtarja D.Sh., në gjykimin në shkallë të parë, ka marrë pjesë vetëm në shqyrtimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar të paraqitur nga kërkuesi, kërkesë kjo që është pranuar nga gjyqtarja. Në vijim, gjyqtarja D.Sh. është larguar nga trupa gjykuese, për shkak të transferimit në GJKKO-në e Apelit, ndërsa pranë kësaj të fundit ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka lënë në fuqi vendimin

e shkallës së parë, duke gjykuar themelin e çështjes. Gjithashtu, nga aktet e vëna në dispozicion nga kërkuesi, nuk rezulton që vendimi i ndërmjetëm për pranimin e gjykimit të shkurtuar të jetë ankimuar nga kërkuesi. Në këndvështrim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se gjyqtarja që ka shqyrtuar çështjen në apel nuk ndodhet para asnjërit prej ndalimeve të parashikuara nga nenet 15 dhe 17 të KPP-së. Ajo ka marrë pjesë në seancë gjyqësore në dhënien e vendimit të ndërmjetëm për pranimin e gjykimit të shkurtuar, por nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes përfundimtare në gjykimin në shkallë të parë, ndaj nuk mund të vihet në dyshim paanshmëria e saj gjatë shqyrtimit të çështjes në apel. Kjo do të thotë se nuk rezulton të ketë bërë vlerësim në lidhje me fajësinë e kërkuesit, çka do të vinte në dyshimin respektimin e standardit të paanshmërisë në gjykim në aspektin objektiv. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar.

35. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.